



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË
V E N D I M

Nr. 87 dt.29.07.1996

MIRATIM FONDI PER EKSPOZITEN E GENOCIDIT KOMUNIST DHE
KTHIMIN E SAHATIT TE TIRANES NE QENDER TE VIZITUESHME

Këshilli Bashkiak i Tiranës, pasi mori në shqyrtim relacionin e Drejtorisë së Kulturës për çelje fondesh për grumbullimin, shumfishimin, materiale arkivore dhe objekte muzeale për ekspozitën e genocidit komunist, veprimtari kjo e Ministrisë së Kulturës në bashkëpunim me bashkitë e vendit në kuadër të çeljes së pavjonit kombëtar të kësaj fushe.

Këshilli mbështetur në ligjin Nr.7572, dt.10.06.1992, neni.45, pika.16 dhe për kthimin e Kullës së Sahatit në pikë të vizitueshme

VENDOSI

1. Të financojë në vlerën 40.000(dyzetmijë) lekë veprimtarinë e Drejtorisë së Muzeumeve për hapjen e ekspozitës së genocidit komunist dhe 70.000(shtatëdhjetëmijë) lekë po kësaj Drejtorie për kthimin e Kullës së Sahatit në pikë të vizitueshme.
2. Ky vendim ndiqet nga Drejtoria e Kulturës duke financuar për qëllimet e mësipërme Drejtorinë e Muzeumeve të Tiranës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

BESNIK PETRELA